VENDIM
Nr.437, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.366, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE"

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 "Për Policinë e Burgjeve", të ndryshuar, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve", e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.366, datë 14.6.2006, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e sherbimi	
			në funksion të policisë të regjimeve të jashtme.	në funksion të policisë të regjimeve të brendshme dhe transferim shoqërimet.
1	2	3	4	5
Bazë	Agjent	31350	4000	7000
	Agjent i I-rë	32400	4000	7000
	Asistent	33600	4000	8000
	Asistent i I-rë	35000	4000	8000
	Kryeasistent	36100	4000	8000
I Mesëm	Neninspektor	46000	4000	6000
	Inspektor	48300	4000	6000
	Kryeinspektor	54250	4000	6000
I lartë	Nënkomisar	65900	4000	6000
	Komisar	80900	4000	6000
	Kryekomisar	92400	4000	6000
Madhor	Drejtues	102000	8000	
	Drejtues i I-rë	109500	8000	